



Vendimi Nr. K-06/25

Datë: 25.02.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 25.02.2025, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET përqendrim lidhur me marrjen e kontrollit direkt dhe indirekt nga, Proteini.si, ndërmarrje e ndërlidhur nga ALFI SKLADI mbi kompaninë SANIVITA si dhe mbi asetet e caktuara të T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashhtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë; 30.12.2024, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 837/24-11/H, lidhur me Njoftimin e Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit direkt dhe indirekt nga, Proteini.si ndërmarrje e ndërlidhur nga ALFI SKLADI mbi kompaninë SANIVITA si dhe mbi asetet e caktuara të T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o

Palët në Përqendrim:

SANIVITA, proizvodnja živil, d.o.o., e themeluar dhe që vepron sipas ligjit Slloven, me adrese në Obrtna cona Ugar 19, 1310 Ribnica, Slloveni, me numër identifikues: 3736610000 (" Target Company- kompania e blerë/targetuar")

Është një biznes i specializuar në suplementet sportive dhe produktet dietike, duke ofruar shërbime prodhimi, asistence në zhvillimin e formulës dhe mbështetje në markimin dhe dizajnin e produkteve për klientët në të gjithë Bashkimin Evropian. Kompania e blere e targetuar nuk ka filiale në Kosovë. Kompania e blere nuk gjeneron të ardhura në Kosovë.

T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o., e themeluar dhe funksionuar sipas ligjit Slloven, me vendodhje në Hrvaska ulica 10, 1000 Ljubljana, Slloveni, numri i regjistrimit 2179644000 (" Asetet e blera- targetuara")

Asetet e blera/targetuara aktualisht janë në pronësi të T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o., e cila nga ana tjetër është në pronësi të HN INVEST, razvoj in investicije, d.o.o., pronari përfundimtar i se cilës është z. Natan Hojč me 100% pronësi në këtë kompani.

Asetet e blera/targetuara nuk gjenerojne të hyra në tregun e Kosovës.

Proteini.si d.o.o., një kompani e themeluar dhe që vepron sipas ligjit Slloven, me adrese të regjistruar në Rr. Ulica Heroja Verdnika 22, 4270 Jesenice, Slloveni, e regjistruar me numrin identifikues: 2024691000 (" Proteini. si " ose " Blerësi i drejtpërdrejte"). Proteini.si është aktiv në prodhimin dhe shitjen e produkteve ushqimore, me fokus në suplementet sportive dhe produkte të tjera sportive. ALFI është pronari i Blerësit Direkt ose Proteini.si dhe do të kontrollohet përfundimisht nga ALFI SKLADI.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 27.01.2025
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me: datë 27.01.2025
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen me date 03 Dhjetor 2024, ndërmjet Proteini.si, si blerës dhe T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o., si shitës.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- I. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
- II. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.

Struktura e Përqendrimit:

Transaksioni ka të bëjë me marrjen e kontrollit mbi kompaninë e blere/targetuar dhe asetet e blera/targetuara. Pas transaksionit:

- Proteini.si si blerësi direkt, do të zotërojë dhe kontrollojë drejtpërdrejt kompaninë e blere/targetuara, ndërsa,
- ALFI SKLADI si njoftuesi, do të zotërojë dhe kontrollojë në mënyre indirekte kompaninë e blere/targetuar dhe asetet e blera/targetuara.

Për realizimin e Transaksionit, ALFI vepron nëpërmjet Proteini.si., i cili është blerësi direkt dhe blerësi në marrëveshjet që përbëjnë bazën e Transaksionit.

Marrëveshja që përbën bazën e transaksionit lind nga një grup dokumentesh që përfshijnë:

- Marrëveshjen e blerjes së aksioneve e nënshkruar me 3 dhjetor 2024, ndërmjet Proteini.si si blerës dhe shitësve të mëposhtëm:
 - HN INVEST, razvoj in investicije, d.o.o; dhe
 - SOCIETE MONDIALE DE COMPLEMENTES NUTRITIONNELS,Si pronar të barabartë të kompanisë së blerë/targetuar.
- Marrëveshja e blerjes së aseteve, e nënshkruar me 3 dhjetor 2024, ndërmjet Proteini.si si blerës dhe T.H.E., tregovina s športno prehrano, d.o.o., si shitës, kjo marrëveshje specifikon mekanizmin për transferimin e pronësisë së aseteve të blera/targetuara të Proteini.si.

Tregu i produktit – tregu përkatës i produktit mund të përkufizohet si treg për prodhimin dhe shitjen e suplementeve dietike sportive, dhe ushqimit produkteve.

Tregu gjeografik-lidhur me shtrirjen gjeografike relevante për Transaksionin, tregu gjeografik përkufizohet si treg ndërkombëtar duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, tregu gjeografik mund të mbetet i hapur, pasi që transaksioni nuk do të ketë efekte negative në konkurrencën në Kosovë, pasi që transaksioni po zhvillohet jashtë Kosovës dhe nuk ka efekte në territorin e saj.

Analiza e konkurrencës

Në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës është përmbushur kriteri ligjor për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim. Transaksioni zhvillohet jashtë Kosovës nuk do të ketë efekte negative në konkurrencën brenda tregut të Kosovës. Konkretisht transaksioni nuk do të dërgojë në krijimin ose forcimin e një pozicioni dominues në treg, nuk do të rezultojë në parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës. Integrimi i operacioneve të SANIVITA me Proteinin.si pritet të dërgojë në: Ekonominë e shkallës në prodhim, prokurim dhe shpërndarje. Ndër promovimi i zgjeruar i produkteve. Mundësi rritje në tregun e suplementeve sportive në të gjithë Slloveninë dhe Ballkanin.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Arsyeja ekonomike për kryerjen e transaksionit, gjegjësisht blerjen e Target Company dhe Target Assets, është marka e krijuar e kompanisë së blerë/targetuar dhe asetëve të blera/targetuara dhe prania e tyre në tregun Slloven. Pasi që transaksioni po zhvillohet jashtë Kosovës dhe nuk ka efekte në territorin e saj, Transaksioni nuk do të rezultojë në parandalimin, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës dhe tregu i Kosovës mbetet i pandikuar nga ky transaksion. Në veçanti nuk do të dërgoj në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese dhe as nuk do të ketë ndonjë efekt negative në tregun e Kosovës.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr.08/L-056 për mbrojtjen e Konkurrencës, llojet e Përqendrimit që kapen nga rregullat e kontrollit të bashkimit janë ato që plotësojnë dy kushte: transaksioni duhet të përbej një Përqendrim sipas kuptimit të nenit 11 të ligjit të konkurrencës dhe duhet të plotësohet pragu i qarkullimit të parashikuar në nenin 13 të ligjit të konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë, nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva